

Udhëzues për punë efektive të **Mekanizmave Koordinues Komunal Kundër Dhunës në Familje (MKKDHF)**



osbe

Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Udhëzues për punë
efektive të

**Mekanizmave Koordinues
Komunal Kundër Dhunës
në Familje (MKKDHF)**

SHKURTESAT

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
ANJF	Agjencia e Ndhmës Juridike Falas
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas
DHBGJ	Dhuna me bazë gjinore
DHF	Dhuna në familje
DHNG	Dhuna ndaj grave
KeS	Konventa e Stambollit
KiE	Këshilli i Evropës
KKKDFH	Koordinatori i Kosovës kundër Dhunës në Familje
KPK	Kodi penal i Kosovës
LMKDFH	Ligji për mbrojtje kundër dhunës në familje
MD	Ministria e Drejtësisë
MKKDFH	Mekanizmi Koordinues Komunal Kundër Dhunës në Familje
MM	Memorandum Mirëkuptimi
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MV	Mbrojtës i Viktimave
OJQ	Organizata Joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PK	Policia e Kosovës
PSV	Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje
QPS	Qendra për Punë Sociale
SKMDHF	Strategjia e Kosovës për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna kundër grave
SKMDHFPV	Strategjia e Kosovës për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave dhe Plani i veprimit
TeR	Termet e referencës
ZKBGJ	Zyrtarët komunalë për barazi gjinore
ZMNV	Zyra për Mbrojtje dhe Ndhmë Viktimave

TABELA E PËRMBAJTJES

I Hyrje	5
Historiku dhe rëndësia e përditësimit të udhëzimeve.....	6
II Baza Ligjore për MKKDHF-të	7
III Qëllimi i MKKDHF-ve	8
IV I Rëndësia e qasjes ndërinstitucionale dhe të koordinuar ndaj dhunës në familje	11
Koordinimi.....	12
Parandalimi dhe ndërgjegjësimi.....	13
Rekomandime për politika për intervenim dhe referim në ofrimin e shërbimeve	14
Nëntë parimet udhëheqëse për një qasje efektive ndërsektoriale në parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.....	15
V Rolet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të MKKDHF-së	18
Anëtarët e MKKDHF-së dhe roli i tyre	19
Roli i Koordinatorit të MKKDHF.....	25
Lista kontrolluese për Koordinatorin e MKKDHF.....	26
VI Takimet e MKKDHF-së	27
Shpeshtësia e takimeve dhe pjesëmarrja në MKKDHF.....	27
Përgatitjet për mbledhjet e MKKDHF-ve.....	27
Mbajtja e mbledhjes së MKKDHF-së	28
Mbyllja e mbledhjes së MKKDHF-së.....	28
Pas mbledhjes të MKKDHF-së.....	29
VII Mbledhja, analizimi dhe raportimi i të dhënave	30
Mbledhja dhe analizimi i të dhënave	30
Raportimi.....	31
VIII Trajnimi dhe zhvillimi i kapaciteteve për anëtarët e MKKDHF-ve	33

SHTOJCAT

Shtojca 1: Korniza ligjore dhe e politikave që rregullojnë MKKDHF-të.....	35
Shtojca 2: Neni 7 i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit)..	37
Shtojca 3: Termat e Referencës së Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (shabllon)	39
Shtojca 4: Procesverbalet e takimeve të MKKDHF-së për të mbështetur koordinatorin e MKKDHF - model.....	42
Shtojca 5: Modeli për raportet tremujore të anëtarëve të MKKDHF dhe raportet tremujore/vjetore të hartuara nga Koordinatorin e MKKDHF	43

I HYRJE

Dhuna në familje (DHF) dhe dhuna kundër grave (DHNG) janë shkelje të papranueshme të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut që prekin shoqëritë në mbarë botën. Në Kosovë, DHF mbetet një nga problemet më serioze me të cilat përballet shoqëria. Gratë janë më me gjasë të pësojnë nga DHF sesa burrat, por ky fenomen prek edhe burrat. Fëmijët (djemtë dhe vajzat) janë shpeshherë viktima ose dëshmitarë të DHF-së. Një anketë e publikuar në vitin 2019 nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) me të dhëna të mbledhura gjatë vitit 2018 zbuloi se 57 për qind e grave të anketuara në Kosovë kishin pësuar dhunë psikologjike, fizike ose seksuale që nga moshë 15 vjeçare. Konkretisht, 53 për qind e grave kishin pësuar dhunë psikologjike, 9 për qind dhunë fizike dhe 4 për qind dhunë seksuale nga partneri intim. Për më tepër, 48 për qind e grave të anketuara (48 për qind) ende e konsiderojnë dhunën e tillë, veçanërisht DHF-në, si çështje private. Kjo shpjegon pse DHF në Kosovë raportohet më pak dhe shpeshherë mbetet e pazbuluar.¹

Për t'i parandaluar incidentet e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave dhe për të reaguar kur ato ndodhin nevojitet një qasje sistematike, ndërsektoriale dhe e koordinuar nga qeveria dhe institucionet përgjegjëse të nivelit lokal. Strukturat aktuale në nivelin lokal janë Mekanizmat Komunalë Koordinues kundër Dhunës në Familje (MKKDHf), qëllimi i të cilave është sigurimi i një reagimi të koordinuar ndaj DHF-së nga autoritetet lokale. MKKDHf-të zakonisht krijohen përmes Memorandumeve të Mirëkuptimit (MM) që përfshijnë palë të ndryshme të interesit si policia, gjyqtarët, prokurorët, shërbimet sociale, zyrtarët komunalë, mbrojtësit e viktimave, organizatat e shoqërisë civile (OSHC) dhe strehimoret.

Deri në mars të vitit 2023 janë themeluar 33² MKKDHf përmes memorandumeve të mirëkuptimit, duke mbuluar kështu shumicën e komunave në Kosovë. Nga këto 33 MKKDHf, 20 janë themeluar me mbështetjen e drejtpërdrejtë të Misionit të OSBE-së në Kosovë, ndërsa pjesa tjetër me mbështetjen e Zyrës së "UN Women" në Kosovë.

1 "Anketa e OSBE-së mbi mirëqenien dhe sigurinë e grave në Kosovë". OSBE 2019. Në dispozicion në: <https://www.osce.org/files/f/439790.pdf>.

2 Deçan, Dragash, Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Glogoc, Graçanicë, Hani i Elezit, Fushë Kosovë, Istog, Kaçanik, Klinë, Kllokot dhe Partesh, Leposaviq, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë e Veriut, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Pejë, Prishtinë, Prizren, Shtime, Skenderaj, Suharekë, Viti, Zveçan, Zubin Potok, Kamenicë, Vushtrri. Në mars të vitit 2023, Misioni mbështeti themelimin e dy MKKDHf-ve, në komunat e Novobërdës dhe Ranillugut.

Fokusi i këtij Udhëzuesi është të ofrojë udhëzime praktike (përfshirë formularë model të dobishëm në shtojca, si ai për raportimin dhe hartim të procesverbaleve të takimeve) për anëtarët e MKKDFH-ve, për të pasur reagim më efektiv dhe më të koordinuar ndaj dhunës në familje në nivel lokal. Udhëzuesi mbulon temat si në vijim: 1) bazën ligjore për MKKDFH-të; 2) qëllimin e MKKDFH-ve; 3) rëndësinë e një qasjeje ndërinstucionale dhe të koordinuar; 4) rolet e anëtarëve të MKKDFH-së, përfshirë atë të koordinatorit; 5) organizimin e takimeve për anëtarët e MKKDFH-së; 6) mbledhjen dhe raportimin e të dhënave; dhe 7) trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të MKKDFH-së.

Ky Udhëzues bazohet në kornizën aktuale që rregullon MKKDFH-të dhe ka për qëllim të shërbejë si mjet praktik për t'u përdorur nga anëtarët në punën e tyre të përditshme. Ndërsa mandati dhe mekanizmi i MKKDFH-ve vazhdojnë të zhvillohen në vitet e ardhshme, ato duhet të ndryshohen dhe plotësohen periodikisht për të adresuar ndryshimet në kornizë dhe nevojat në rritje.

Historiku dhe rëndësia e përditësimit të udhëzuesit

Udhëzuesi është hartuar si pjesë e Projektit Jashtëbuxhetor "Përkrahja e mekanizmave për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje në komunat e Prishtinës, Mitrovicës Jugore, Mamushës dhe Graçanicës (Pilot Projekti)" i financuar nga Qeveria e Francës. Pilot komunat Prishtinë, Graçanicë, Mitrovicë Jugore dhe Mamushë janë përzgjedhur për të reflektuar diverzitetin në Kosovë. Mamusha është e banuar kryesisht nga komuniteti turk, ndërsa Graçanica nga komuniteti serb.

Vlen të përmendet se të gjitha të dhënat e ofruara në dokument bazohen në aktivitetet monitoruese të Misionit të OSBE-së në Kosovë gjatë pesë viteve të fundit. Udhëzuesi është rezultat i konsultimeve gjithëpërfshirëse me anëtarët e MKKDFH-ve në mbarë Kosovën dhe seminareve të zhvilluar me katër MKKDFH të synuara në komunat e Prishtinës, Graçanicës, Mitrovicës Jugore dhe Mamushës. Ky Udhëzues duhet të përditësohet rregullisht me miratimin e ligjeve të reja që prekin MKKDFH-të dhe me ndryshimin e situatës.

Pavarësisht publikimit të Udhëzuesit, Misioni i OSBE-së në Kosovë inkurajon komunat që të përgatisin rregulloret e tyre të brendshme të cilat do të lehtësojnë funksionimin e plotë dhe të duhur të MKKDFH-ve dhe do të përcaktojnë në hollësi punën dhe rolet e MKKDFH-ve të tyre përkatëse, duke përfshirë përbërjen, takimet dhe raportimin bazuar në nevojat e tyre lokale.

II BAZA LIGJORE PËR MKKDHF-TË

Baza ligjore aktuale për MKKDHF-të është neni 7 i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) (Shih Shtojcën 1), e cila kërkon qasje të punës nga shumë agjenci për ta luftuar dhunën në familje. Konventa e Stambollit është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë, në kuadër të nenit 22 të Kushtetutës.

Dhuna në familje është vepër penale e sanksionuar në Kodin Penal të Kosovës dhe trajtohet në ligje dhe politika të tjera të ndryshme (shih Shtojcën I). Kjo përfshin *Ligjin nr. 03/L-182 për mbrojtjen nga dhuna në familje, Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje në Kosovë (2013)*, dhe *Strategjinë e Kosovës për mbrojtje nga dhuna në familje 2022-2026*.

Kosova është në proces të miratimit të një ligji të ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga DHF, DHNG dhe dhuna me bazë gjinore (DHBGJ). Ligji i ri do të harmonizohet me standardet e Konventës së Stambollit. Gjithashtu, ligji synon të përfshijë dispozita të veçanta ligjore që do të sigurojnë themelimin e duhur të MKKDHF-ve, duke përfshirë aktet nënligjore të reja që kërkojnë reagim ndërinstucional ndaj DHF-së dhe DHNG-së, dhe ofrim të mbështetjes shtesë ligjore administrative dhe ekonomike për mekanizmat. Ligji i ri do t'i trajtojë edhe format e tjera të DHNG-së, përveç DHF-së.

Ky Udhëzues duhet të përditësohet çdo vit për t'i marrë parasysh zhvillimet e reja ligjore në Kosovë dhe për t'i përditësuar praktikatat e mira për funksionimin e MKKDHF-ve.

III QËLLIMI I MKKDHF-VE

Qëllimi i MKKDHF-ve është të përmirësojë bashkëpunimin ndërinstitucional në rastet e dhunës në familje dhe të përmirësojë reagimin e politikave institucionale lokale ndaj dhunës në familje. Çdo anëtar institucional i MKKDHF ka përgjegjësi sektoriale bazuar në Procedurat Standarde Veprimit (PSV) për mbrojtje nga dhuna në familje³ dhe Memorandumin e Mirëkuptimit përkatës që themelon atë MKKDHF.

MKKDHF-të përbëhen nga përfaqësues të sektorëve të ndryshëm⁴, si administrata komunale, agjencitë e zbatimit të ligjit, gjyqësori, arsimit dhe shëndetësia, organizatat joqeveritare të grave, agjencitë për mbrojtjen e fëmijëve, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV), zyrat rajonale të punësimit; komunitetet fetare dhe partnerë të tjerë përkatës.

Një përfaqësues për çdo institucion, dhe/ose një anëtar zëvendësues i anëtarit të përhershëm, sipas nevojës, merr pjesë në mbledhjet e rregullta të MKKDHF-së. Institucione të tjera që nuk janë anëtarë të përhershëm të MKKDHF-së mund të ftohen që të kontribuojnë në takim me miratim të anëtarëve të MKKDHF-së. Institucione të tilla do të ftohen veçmas në çdo takim.

Vlerësimi i kryer nga Misioni i OSBE-së në Kosovë në vitin 2022 ka identifikuar se komuna të ndryshme ftojnë dhe angazhojnë sektorë të ndryshëm në reagimin e tyre ndërsektorial ndaj DHF-së. Kjo nuk është e pazakontë pasi secili kontekst është i ndryshëm dhe mund të kërkojë angazhimin e anëtarëve shtesë gjatë zhvillimit të politikave lokale për parandalimin e DHNG.

3 <https://abgj.rksgov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/Procedurat%20Standarte%20t%C3%AB%20Veprimit%20p%C3%ABr%20Mbrojtje%20nga%20Dhuna%20n%C3%AB%20Familje.pdf>

4 Varësisht nga struktura e komunave, disa nga drejtoritë shkrihen në një, përkatësisht në një Drejtori komunale të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale. Për më tepër, disa nga nënshkruarit, d.m.th. ZMNV, ANJF, gjykata themelore, prokuroria themelore dhe menaxheri i strehimoreve marrin pjesë në MKKDHF të shumë komunave.

Memorandumet e mirëkuptimit shpeshherë ndryshojnë sipas komunave bazuar në nevojat e tyre të veçanta. Megjithatë, çdo memorandum mirëkuptimi zakonisht përcakton qëllimin dhe funksionet e MKKDHF-së si vijon:

- Të krijojë dhe të bashkërendojë punën e palëve relevante të interesit në komunë për t'u marrë me çështjet e DHF/DHNG në nivel lokal;
- Të hartojë procedura dhe protokolle të përbashkëta;
- Të lehtësojë mbledhjen e integruar të të dhënave;
- Të avokojë për ndarjet buxhetore nga administrata komunale;
- T'i identifikojë referimet për shërbime specifike;
- T'i identifikojë nevojat dhe të ofrojë mbështetje shtesë, sipas nevojës, për viktimat e DHF dhe DHNG nga grupet e cënueshme, duke përfshirë komunitetet joshumicë, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit;
- Të rrisë ndërgjegjësimin dhe të ndërtojë kapacitete për zhvillimin e tolerancës zero ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
- Të bashkërendojë përpjekjet me OSHC-të për të drejtat e grave;
- Për të siguruar efikasitet dhe efektivitet në takime, anëtarët e MKKDHF duhet të tregojnë përkushtim, të marrin pjesë rregullisht në takime dhe të kontribuojnë.

Ndonëse disa memorandume ekzistuese përmendin menaxhimin dhe përcjelljen e rasteve, kjo çështje duhet të shqyrtohet me kujdes për të mbrojtur privatësinë dhe të drejtat e viktimave për konfidencialitet. Në përgjithësi, rastet individuale dhe informacionet private (si emri, adresa, etj.) nuk duhet të zbulohen gjatë punës së MKKDHF-ve; menaxhimi i rasteve duhet të diskutohet vetëm në nivel politikash në takimet e MKKDHF.

Sipas praktikave të mira ndërkombëtare, reagimi ndërsektorial mund të funksionojë në dy nivele:

Në **nivel të politikave**, ku përfshihen përfaqësues të nivelit të lartë të secilës agjenci përkatëse, si anëtarë të reagimit ndërsektorial në nivel të politikave (p.sh. kryetarët e komunave/zyrtarët komunalë, përfaqësuesit e sektorit të policisë, shëndetësisë, shërbimeve sociale, gjyqësorit, arsimit dhe OSHC-ve). Ky organ vendimmarrës miraton veprimet e përbashkëta (plane të koordinuara, strategji, burime, etj.) dhe i kushton vëmendje të veçantë monitorimit të punës së përbashkët. Bashkëpunimi i ndërinstitucional në nivel të politikave funksionon si reagim politikash. Kompetencat për të ndarë burime të nevojshme, përfshirë financiare, janë jetike për funksionimin efektiv të këtij organi.

Niveli i **menaxhimit të rastit** (që ndryshe njihen edhe si ekipe mobile të emergjencës) përfshin profesionistë dhe specialistë që merren drejtpërdrejt me rastet e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave (profesionistë nga njësia e policisë për DHF, mbrojtës të viktimave, prokurorë, gjyqtarë, anëtarë të specializuar të personelit mjekësor, mjekë ligjorë, anëtarë të shërbimeve sociale, OSHC-të e grave, etj.). Këta profesionistë të specializuar janë të trajnuar dhe kanë autorizime për të reaguar për t'i mbrojtur viktimat, për t'i ndjekur penalisht autorët dhe për të zbatuar masa të përbashkëta parandaluese në përputhje me nevojat e viktimës.⁵ Meqenëse këto ekipe funksionojnë në nivel teknik, ato duhet të krijohen në çdo komunitet. Për shkak të të drejtave të privatësisë, specifikat që kanë të bëjnë me të dhënat personale⁶ në rastet individuale nuk duhet të diskutohen gjatë punës së MKKDDHF-ve. Mund të diskutohen informacione të përgjithshme në lidhje me menaxhimin e rasteve në nivel të politikave, si statistikave të përgjithshme (numri i rasteve, gjinia, grupmoshat, etj.) me qëllim të përmirësimit të procedurave.

5 Zakonisht, këto ekipe aktivizohen në dy nivele: (1) për të akomoduar nevojat e menjëhershme të viktimave, duke përfshirë sigurinë e viktimës, strehimin dhe mbështetjen e kujdesit shëndetësor; dhe (2) për të ofruar mbrojtje dytësore, duke përfshirë strehimin afatgjatë, mbështetjen e kujdesit për fëmijët, punësimin, shërbimet e këshillimit për viktimat dhe mbështetjen e vazhdueshme që do të sigurojë një jetë pa dhunë.

6 "Të dhënat personale" do të thotë çdo informacion në lidhje me personin fizik të identifikuar ose të identifikueshëm ("subjektin e të dhënave"); personi fizik i identifikueshëm është ai që mund të identifikohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi si emri, numri i identifikimit, të dhënat e vendndodhjes, identifikuesi në internet ose një a më shumë faktorë specifikë fizikë, fiziologjikë, të identitetit gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik. Neni 4 i Rregullores së përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave të Bashkimit Evropian <https://gdpr.eu/article-4-definitions>

IV RËNDËSIA E QASJES NDËRINSTITUCIONALE DHE TË KOORDINUAR NDAJ DHUNËS NË FAMILJE

Reagimi ndërsektorial ndaj dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave përfshin një qasje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar. Koordinimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm siguron që viktimave dhe të mbijetuarve të dhunës në familje t'u ofrohen shërbime në kohën e duhur dhe në bazë të nevojave të tyre. Për më tepër, me koordinim sigurohet që reagimet e ndryshme institucionale plotësojnë dhe modifikojnë njëra-tjetrën, duke siguruar që ndërhyrjet të jenë të përqendruara te viktima si dhe që përvojat dhe nevojat e viktimave të trajtohen në tërësi. Reagimi ndërsektorial ka për qëllim harmonizimin e programeve dhe veprimeve, të zhvilluara dhe të zbatuara nga një sërë institucioneve që merren me mirëqenien psikosociale, zbatimin e ligjit (policia, mbrojtësit e viktimave, prokurorët dhe zyrtarët e drejtësisë), arsimin, shëndetësinë, zyrtarë të drejtorive komunale, institucione joqeveritare dhe sektorë të tjerë relevantë. Kjo qasje bazohet në partneritet dhe bashkëpunim ndërinstitutional. Ajo kërkon mirëkuptim të përbashkët nga të gjitha institucionet e përfshira për marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit mes burrave dhe grave në kontekstin e DHNG për ta trajtuar këtë fenomen. Pra, shkaqet e kësaj dhune duhen gjetur jo vetëm në nivel individual, por, në veçanti, edhe në nivel strukturor. Këto shkaqe duhet të eliminohen për ta parandaluar dhunën e mëtejshme. Më konkretisht, një qasje efektive ndërsektoriale dhe e koordinuar për DHF-në dhe DHNG-në përfshin, mes tjerash, elementet si në vijim:

- Aplikimi i reagimit tërësor ndaj të gjitha formave të DHNG-së dhe DHF-së;
- Krijimi i një sistemi funksional të ndërhyrjes që u mundëson viktimave të kenë qasje në mbrojtje dhe mbështetje në të gjithë zonën përkatëse të përgjegjësisë;
- Pjesëmarrja e të gjitha autoriteteve, institucioneve, ofruesve të shërbimeve dhe profesionistëve të përfshirë në parandalimin dhe luftimin e dhunës në sistemet e ndërhyrjes me një qasje të ndjeshme gjinore;
- Avokimi për programe rehabilitimi dhe riintegrimi siç është fuqizimi ekonomik, iniciativat lokale dhe qasja në banimin social.
- Zhvillimi dhe zbatimi i strategjive, protokolleve dhe udhëzuesve ndërsektoriale, të cilët sigurojnë koordinimin e duhur në mënyrë që të gjithë sektorët dhe nivelet të angazhohen në mënyrë adekuate;
- Angazhimi i fuqishëm i autoriteteve rajonale dhe lokale, veçanërisht i organizatave për të drejtat e grave dhe viktimave ose OSHC-ve, për të punuar me grupe specifike të viktimave siç janë emigrantët, të kthyerit dhe/ose gratë me aftësi të kufizuara;

- Aplikimi i një qasjeje me fokus në viktimë, gjatë zbatimit të politikave dhe masave gjithëpërfshirëse dhe të koordinuara;⁷ dhe
- Zhvillimi i mjeteve dhe formularëve adekuatë për marrjen e pëlqimit të viktimës, formatet e referimit, si dhe të dhëna të tjera.

Gjatë shqyrtimit të themelimit të mekanizmit koordinues ndërsektorial të DHF-së/DHNG-së në nivel lokal, komnatat duhet t'i marrin parasysh nevojat e përfituesve dhe ta kuptojnë kontekstin lokal. Kjo do të sigurojë efektivitetin dhe qasje në shërbimet bazë për viktimat në afat të gjatë.

Për më tepër, koordinimi i planifikuar dhe i vendosur mirë siguron sinkronizim të punës së të gjitha institucioneve dhe parandalon riviktimizimin e grave dhe fëmijëve.

Një qasje e tillë sistematike rrit besimin e viktimës në sistem dhe i siguron asaj mbështetjen e duhur në periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë, të bazuar në komunitet.

Elementet e hartimit të politikave ndërsektoriale për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje në nivelin lokal

Koordinimi

Koordinimi siguron një reagim më të parashikueshëm, të përgjegjshëm dhe efektiv ndaj DHNG-së dhe DHF-së. Koordinimi në nivelin lokal kërkon që të gjithë anëtarët e MKKDHF-së, duke përfshirë administratën komunale, gjyqtarët, policinë, prokurorët dhe OSHC-të përkatëse të punojnë së bashku për të arritur një qëllim të përbashkët. Ata punojnë në partneritet dhe krijojnë një sistem ku veprimet/intervenimet plotësojnë njëra-tjetrën dhe e rrisin rezultatin përfundimtar. Kjo siguron më tej politika të qasshme, konfidenciale dhe të përshtatshme që i mbrojnë viktimat. Koordinimi ndërsektorial ndërmjet akterëve relevantë është shumë i rëndësishëm për të sjellë ndryshime të qëndrueshme në një shoqëri ku dhuna nuk është e pranueshme ose e tolerueshme.⁸ Koordinimi gjithashtu nënkupton që të theksohet vazhdimisht se parandalimi dhe reagimi ndaj DHF-së dhe

7 Raporti shpjegues për Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, Stamboll, nenet 5, 7 dhe 9, KiE, 11.V.2011 <https://rm.coe.int/16800d383a>

8 Reagimi multi-sektorial ndaj DHBGJ-së <https://eeca.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/Multisectoral%20response%20to%20GBV.pdf>

DHNG-së është përgjegjësi e të gjithëve në komunitet. Koordinimi mundëson që ofruesit e shërbimeve të sigurojnë një rrjet efektiv, të menjëhershëm dhe të qëndrueshëm të shërbimeve dhe përmirëson cilësinë e shërbimeve të ofruara për viktimat/të mbijetuarat e DHF-së. Për më tepër, ai siguron që të gjithë ofruesit e shërbimeve të kenë qasje në programet e trajnimit që rezultojnë në ofrimin e mbështetjes së ndjeshme dhe efikase për viktimat/të mbijetuarat bazuar në nevojat e tyre, si dhe reduktimin e riviktimizimit. Përfundimisht, kjo do të rrisë besimin e viktimave/të mbijetuarave në institucione.⁹ Së fundi, koordinimi siguron dhe promovon një kuptim të përbashkët të çështjeve të DHNG-së dhe DHF-së mes institucioneve kryesore që hartojnë politika. Koordinimi mbështet standardet minimale të DHNG-së, monitoron respektimin e parimeve udhëheqëse për DHNG-në, lehtëson shkëmbimin e informatave rreth praktikave më të mira dhe promovon veprimet kolektive ndërinstitucionale për të parandaluar këtë dukuri dhe për të reaguar në të.

Parandalimi dhe ndërgjegjësimi

Për të parandaluar DHNG-në dhe DHF-në, si institucionet ashtu edhe individët duhet t'i kuptojnë shkaqet kryesore të tyre. Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje rrjedhin nga dy elemente të përbashkëta: 1) dëshira për të ushtruar pushtet dhe kontroll mbi një person tjetër, dhe 2) pabarazia strukturore gjinore dhe diskriminimi. Përmes parandalimit të dhunës ndaj grave synohet të kuptohen shkaqet dhe faktorët që kontribuojnë në dhunën e ushtruar ndaj grave dhe të krijohen strategji për reduktimin ose eliminimin e saj. Parandalimi kërkon planifikim dhe zbatim afatgjatë për të parashikuar ndryshime thelbësore në statusin ekonomik, social dhe politik të dhunës ndaj grave dhe viktimave/të mbijetuarave të dhunës në familje dhe ndryshime në normat sociale që tolerojnë sjelljet abuzive. Ai gjithashtu kërkon monitorimin e trendeve dhe projektimin e ndërhyrjeve për t'i adresuar këto trende.

Një nga mënyrat për të parandaluar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje është investimi në rritjen e ndërgjegjësit, me qëllim që:

1. Të parandalohet që burrat dhe gratë të bëhen të dhunshëm ndaj grave viktimave/të mbijetuara ose kryerësve;
2. Të ndryshohen qëndrimet, sjelljet dhe besimet, si dhe zhvillimit të tolerancës zero nga publiku i gjerë; dhe
3. Të informohet opinioni publik lidhur me shërbimet dhe mekanizmat mbrojtës që janë në dispozicion në nivelin lokal.

Nëse DHF-ja dhe DHNG-ja nuk vlerësohen nga të gjithë si problematikë që prek komunitetin, ngritja e ndërgjegjësimit duhet të jetë prioritet kryesor për anëtarët e MKKDHF-së.

Së fundi, mediat ndikojnë shumë në zhvillimin e tolerancës zero ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Prandaj, MKKDHF-ja duhet të bashkëpunojë ngushtë me mediat lokale. MKKDHF-të duhet të krijojnë partneritete me transmetuesit medialë dhe t'i përdorin ato dhe mediat sociale për të përçuar mesazhe të qarta me fokus në llojet e DHF-së, shkaqet dhe pasojat e saj, si dhe burimet dhe shërbimet e disponueshme për viktimat/të mbijetuarit. Ndërkohë, mediat duhet të shmangin raportimin sensacionalist për dhunën ndaj grave (duke përfshirë detaje për viktimat/të mbijetuarat, numrin e prerjeve dhe goditjeve, etj.).

Rekomandime për politika për intervenim dhe referim në ofrimin e shërbimeve

Mekanizmi ndërsektorial i koordinimit është përgjegjës për inicimin, sugjerimin, vlerësimin dhe monitorimin e rekomandimeve të politikave të dërguara dhe të miratuara nga Kuvendi Komunal dhe administrata, duke përfshirë institucionet përgjegjëse që merren me DHF-në në nivelin lokal. Ato duhet të bazohen në interesin më të mirë të viktimave dhe fëmijëve të tyre dhe të përshtaten me kontekstin dhe nevojat e popullatës lokale. Përveç kësaj, mekanizmi ndërsektorial i koordinimit duhet të sigurojë:

1. koordinim,
2. zbatim,
3. monitorim dhe
4. vlerësim të politikave dhe masave të miratuara për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje.¹⁰

Të gjithë anëtarët e MKKDHF-së duhet të avokojnë në institucionet e tyre përkatëse për zbatimin e politikave dhe programeve të fokusuara në luftimin e DHF-së dhe DHNG-së në komunën e tyre.

Anëtarët e MKKDHF-së duhet të mbahen të informuar në mënyrë të përgjithshme, pa referenca për raste individuale. Për shembull, të supozojmë se një anëtar i MKKDHF-së

10 <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treatynum=210>

lokale ka informatë për një rast të veçantë. Në atë situatë, ky rast duhet t'i referohet në mënyrë konfidenciale një profesionisti të menaxhimit të rastit të DHF-së, siç për shembull një hetuesi lokal në polici për DHF-në, punëtori social, OSHC-je ose strehimoreje.

Nëntë parimet udhëheqëse për një qasje efektive ndërsektoriale në parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje

Për pasur funksionim efektiv, MKKDHF-të duhet t'i përfshijnë në punën e tyre të përditshme këto parime, meqë ato janë kyçe në parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje:

- 1) **Partneriteti** - Reagimi ndërsektorial ndaj DHF-së/DHNG-së nënkupton bashkëpunim dhe koordinim të mirë të institucioneve/organizatave të angazhuara përmes anëtarëve të MKKDHF-ve.
- 2) **Planifikimi strategjik** - Të gjitha politikat për DHF-së/DHNG-në të zhvilluara nga MKKDHF-të duhet të përkthehen në strategji të përbashkëta ndërinstucionale, me objektiva dhe aktivitete specifike.
- 3) **Llogaridhënia** - Të gjithë anëtarët e MKKDHF-ve duhet të jenë të përgjegjshëm në përfshirjen e tyre dhe veprimet e programeve/rregullave të dakorduara të secilit mekanizëm të veçantë dhe t'i ndjekin këto parime udhëheqëse në punën e tyre.¹¹
- 4) **Qasja e bazuar në të drejta** - gjatë hartimit të politikave parandaluese dhe mbrojtëse për DHF/DHNG në nivelin lokal, MKKDHF-të duhet të aplikojnë qasje të bazuar në të drejta, duke i dhënë prioritet sigurisë dhe mirëqenies së grave dhe vajzave, dhe duke i trajtuar gratë dhe vajzat me dinjitet, respekt dhe ndjeshmëri. Ky parim kërkon edhe avokim dhe vendosje të standardeve më të larta të shërbimeve shëndetësore, sociale, të drejtësisë dhe të shërbimit policor – shërbime të cilësisë së mirë, të disponueshme, të qasshme dhe të pranueshme për gratë dhe vajzat.
- 5) **Avancimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave** - MKKDHF-të duhet të kuptojnë se pabarazia gjinore dhe diskriminimi janë shkak dhe pasoja

11 <https://eeca.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/Multisectoral%20response%20to%20GBV.pdf>

kryesore e dhunës ndaj grave dhe vajzave. Prandaj, në të gjitha veprimet e tyre ata duhet të aplikojnë një qasje të ndjeshme gjinore gjatë hartimit të politikave dhe praktikave mbështetëse në nivelin lokal. Për më tepër, këto politika duhet të promovojnë fuqizimin e grave dhe vendimmarrjen e pavarur gjatë zgjedhjes së shërbimeve të tilla mbështetëse.

- 6) **Ndjeshmëri kulturore dhe të përshtatshme për moshën** - Puna e MKKDFH-ve duhet të përfshijë një qasje të përshtatshme për kulturën dhe moshën. Kjo do të thotë se të gjitha politikat e zhvilluara nga ky organ duhet t'u përgjigjen rrethanave individuale dhe përvojave jetësore të kategorive të ndryshme të grave duke marrë parasysh moshën, identitetin, kulturën, përkatësinë etnike, fenë, përkatësinë sociale dhe preferencat gjuhësore.
- 7) **Qasja me fokus në viktimat** - Politikat dhe intervenimet e sugjeruara nga MKKDFH-të duhet gjithmonë të konsiderojnë qasjet me fokus në viktimat/të mbijetuarat. Kjo siguron që të gjitha ndërhyrjet, përfshirë ofrimin e shërbimeve në nivelin lokal, të kenë gjithmonë parasysh të drejtat, nevojat dhe dëshirat e grave dhe vajzave. Për këtë duhet marrë parasysh nevojat e shumta të viktimave dhe të të mbijetuarave, rreziqet dhe dobësitë e ndryshme, si dhe ndikimin e vendimeve dhe veprimeve të marra, duke siguruar që të gjitha politikat u përshtaten kërkesave të veçanta të secilës grua dhe vajzë.
- 8) **Siguria/konfidencialiteti janë parësore** - Siguria e grave dhe vajzave është parësore; prandaj, MKKDFH-të duhet të sigurojnë konfidencialitet të plotë dhe të mos zbulojnë asnjë informatë për rastet individuale. Për më tepër, menaxhimi individual i rasteve duhet të jetë jashtë fushëveprimit të punës së MKKDFH-ve. Ato janë organe të politikave lokale dhe vetëm profesionistët e përfshirë në menaxhimin e rastit duhet të jenë të pranishëm gjatë hapave të ndërhyrjes, përveç rasteve kur një person mund të shoqërojë viktimën/të mbijetuarin/ën me kërkesën e tij/saj. MKKDFH-të duhet t'i japin përparësi sigurisë së viktimave/të mbijetuarave dhe fëmijëve të tyre dhe të aplikojnë parimin "mos bëj dëm".
- 9) **Përgjegjësia e kryerësit** - Roli i MKKDFH-ve është të avokojnë që politikat lokale të kenë tolerancë zero ndaj mosndëshkimit të kryerësve, duke siguruar qasje të duhur në drejtësi për gratë dhe fëmijët viktimat të DHNG-së/DHF-së. Megjithatë, duhet të respektohen të drejtat e të akuzuarve gjithashtu sipas kodit të

procedurës penale dhe standardeve të pranuara ndërkombëtarisht për gjykim të drejtë. Ata që dënohen pasi të jenë zbatuar parimet për gjykim të drejtë, duke përfshirë gjykimin para një gjykate të drejtë, të pavarur dhe të paanshme, dhe të bazuar në prova të pranueshme, duhet të përballen me drejtësinë. Gjatë të gjitha përpjekjeve të tyre për rritjen e ndërgjegjësimit, MKKDHF-të synojnë jo vetëm viktimat/të mbijetuarat, por edhe kryerësit. MKKDHF-të duhet të avokojnë që viktimat të kenë zë gjatë qasjes në drejtësi.¹² Megjithatë, vëmendja duhet t'i kushtohet jo vetëm dënimit, por edhe trajtimit dhe rehabilitimit të fajtorëve për veprat penale të DHF-së, në mënyrë që ata të mund të riintegrohen në shoqëri dhe të mos jenë recidivistë. Në strategjitë intervenuese të Kosovës duhet të integrohen programet për kryerësit, ashtu që të adresohet dhuna ndaj grave, qëllimi parësor i të cilave është mbrojtja dhe mbështetja për viktimat. Në veçanti, programet për kryerësit ende nuk janë pjesë e reagimit sistematik të Kosovës kundër dhunës ndaj grave. Megjithatë, legjislacioni i ri do të sigurojë një bazë ligjore për zhvillimin e intervenimeve për të ndryshuar sjelljen e kryerësit.

12 UN Women, UNFPA, OBSH, UNDP dhe UNODC, Paketa e shërbimeve thelbësore për gratë dhe vajzat që i nënshtrohen dhunës, 2015 <https://www.unfpa.org/essential-services-package-women-and-girls-subject-violence>

V ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E ANËTARËVE TË MKKDHF-SË

Anëtarët e MKKDHF-së mund të kontribuojnë në funksionimin dhe koordinimin më të mirë të MKKDHF-së duke marrë pjesë rregullisht në takime, duke kontribuar në diskutime, si dhe duke i ndjekur trendet dhe raportuar për to. Disa nga rolet dhe përgjegjësitë që vlejné për të gjithë anëtarët e MKKDHF-së:

- Secili anëtar i MKKDHF-së duhet t'i sigurojë koordinatorit të MKKDHF-së të dhëna statistikore të grumbulluara për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, duke vënë në pah sfidat specifike me të cilat përballen viktimat në sektorin e tyre të veçantë, si dhe zhvillimet dhe trendët e fundit;
- Secili anëtar i MKKDHF-së duhet të jetë i njoftuar me shërbimet lokale të mbrojtjes dhe të ketë kontakte me ofruesit e shërbimeve për referimet e nevojshme sipas PSV-ve;¹³
- Secili anëtar i MKKDHF-së duhet të avokojë për riintegrimin dhe riatdhesimin e të mbijetuarave të dhunës në familje dhe shërbime lokale më të qëndrueshme dhe përfshirëse gjinore për gratë dhe vajzat viktimat të DHF-së dhe DHBGJ-së, duke përfshirë programet e fuqizimit ekonomik dhe banimin social.
- Secili anëtar i MKKDHF-së duhet t'i dorëzojë Koordinatorit të MKKDHF-së raporte të shkruara tremujore (ose më të shpeshta) narrative dhe statistikore;
- Gjatë takimeve, anëtarët e MKKDHF-ve duhet të paraqesin pasqyra statistikore si dhe veprimet, zhvillimet dhe sfidat specifike për institucionin/punëdhënësin e tyre përkatës;
- Duhet të ketë koordinim të drejtpërdrejt me anëtarët e tjerë të MKKDHF-ve për t'i mbështetur viktimat e dhunës në familje.

E rëndësishme: Të gjithë anëtarët e MKKDHF-së duhet t'i respektojnë të drejtat e privatësisë dhe standardet e konfidencialitetit dhe të mos zbulojnë informata personale, siç janë emrat e viktimave ose të dhënat personale.

Të gjithë anëtarët e MKKDHF-së duhet të avokojnë për mbështetje logjistike dhe administrative nga institucionet që përfaqësohen me anëtarë të MKKDHF-së –si organizimi i takimeve dhe ndarja e kohës për stafin për të marrë pjesë në takime të MKKDHF-së dhe përfshirja e detyrave në MKKDHF në përshkrimet e vendeve të punës.

13 Sipas PSV-së, një rast i dhunës në familje identifikohet si i tillë kur raportohet ose i referohet njërit prej akterëve vijues, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: policinë, qendrën për punë sociale, mbrojtësit e viktimave, strehimoret, linjat e ndihmës, organizatat joqeveritare apo institucionet e tjera.

Pjesëmarrja në MKKDHF duhet të konsiderohet si përgjegjësi institucionale dhe pjesë e kushteve ekzistuese të punës, e jo punë shtesë ose post vullnetar. Për më tepër, përshkrimet e punës së nëpunësve të ndryshëm civilë duhet të rishikohen dhe përditësohen për të pasqyruar zhvillimet në legjislacion.

Anëtarët e MKKDHF-së dhe roli i tyre

Lista e mëposhtme e anëtarëve tipikë të MKKDHF-së përshkruan shkurtimisht rolin e tyre tipik institucional (me fokus në detyrat që kanë të bëjnë me DHF) dhe mënyrën se si ata mund të kontribuojnë në funksionimin më të mirë të MKKDHF-ve. Lista nuk është shteruese dhe përbërja përfundimtare e MKKDHF-ve në komuna të ndryshme varet nga struktura dhe nevojat e komunës.

Përfundimisht, çdo anëtar i përzgjedhur si koordinator (diskutuar më poshtë më gjerësisht), krahas rolit si përfaqësues i një institucioni, duhet të kryejë detyra që kanë të bëjnë me rolin e koordinimit të MKKDHF - duke përfshirë caktimin e takimeve, përcaktimin e agjendave dhe sigurimin e mbajtjes së procesverbaleve dhe hartimit të raporteve.

Kryetari i Komunës, Nënkryetari i Komunës ose përfaqësuesi i administratës komunale:

- Merr sipër rolin kryesor në themelimin, monitorimin dhe mbështetjen e MKKDHF-së;
- Mbështet hartimin e dokumenteve të brendshme që ndihmojnë funksionimin e MKKDHF dhe sigurojnë zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit;
- Pranon, mbledh dhe analizon raportet mbi të dhënat përkatëse statistikore të kategorizuara sipas gjinisë nga koordinatori i MKKDHF për vendime dhe politika përkatëse komunale të mirëinformuara;
- Pranon dhe analizon raportet tremujore dhe vjetore për punën e MKKDHF-ve nga Koordinatorin;
- Siguron dhe bashkërendon mbështetjen e nevojshme për institucionet që merren me rastet e dhunës në familje;
- Vendos të mbijetuarat e dhunës në familje në programet komunale të banimit social (nevojë kryesore e identifikuar e viktimave) dhe programe të tjera komunale që synojnë grupet e cënueshme; dhe
- Avokon brenda institucioneve qeveritare, sektorit privat dhe donatorëve për të siguruar mbrojtje dhe riintegrim të të mbijetuarve të dhunës në familje

- Siguron transferim efektiv të rolit udhëheqës të kryetarët/zyrtarët e ardhshëm të komunave pas zgjedhjeve lokale dhe ndryshimeve pasuese.

Zyrtari komunal për barazi gjinore:

- Mbështet koordinatorin dhe MKKDFH-në;
- Ndërmerr masa të nevojshme për të avokuar dhe promovuar programe kundër dhunës në familje dhe për fuqizimin e grave.

Drejtoria Komunale për Arsim:

- Siguron që viktimat e dhunës në familje, veçanërisht fëmijët dhe gratë e reja, të kenë qasje në arsim;
- Inkurajon krijimin e një mjedisi të sigurt për nxënësit viktimë të dhunës në familje, në përputhje me çdo urdhër mbrojtjeje në fuqi;
- Harton materiale mësimore/promocionale plotësuese për tema të ndryshme që kontribuojnë në promovimin e mosdhunës, gjegjësisht zgjidhje jo të dhunshme të konflikteve në marrëdhëniet ndërpersonale, dhunën në familje, ngacmimet, ngacmimet seksuale në mjedisin arsimor dhe rolin e institucioneve arsimore;
- Përfshin temat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në programet e trajnimit për mësimdhënësit, stafin administrativ dhe punonjësit e tjerë të shkollave dhe drejtorisë;
- Kontribuon në hartimin e kurrikulave formale dhe joformale për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje;
- Krijon ose mbështet programe për t'i mësuar kryerësit të dhunës në familje që të përvetësojnë sjellje jo të dhunshme në marrëdhëniet ndërpersonale në përputhje me Konventën e Stambollit;
- Harton plane pune për fushata ndërgjegjësimi për nxënësit dhe fëmijët, duke ofruar informacion për zhvillimet, incidentet, mekanizmat, ligjet dhe mbështetjen e mundshme për viktimat e dhunës në familje;
- Inkurajon krijimin e mekanizmave për nxënësit ku këta mund të raportojnë dhe të ngrenë shqetësime për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje brenda ose jashtë shkollës;
- Ndan me anëtarët e MKKDFH informacion përkatës mbi dinamikën e dhunës në familje dhe progresin e aktiviteteve në fushën e arsimit.

Drejtoria Komunale e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale:

- Siguron që viktimat e DHF dhe DHNG të marrin shërbime mjekësore dhe mbështetje financiare kur viktima raportohet në qendrën e kujdesit shëndetësor familjar;
- Menaxhon shërbimet sociale në komunë dhe në qendrat shëndetësore familjare;
- Avokon pranë kuvendit komunal që të përfshijë viktimat e DHF dhe DHNG si përfituese të mundshme të skemave të banimit social;
- Referon në mënyrë konfidenciale viktimat e mundshme të dhunës në familje anëtarëve të tjerë relevantë të MKKDHF-së (polici, strehimore, QPS dhe/ose mbrojtësit e viktimave) në përputhje me PSV-në dhe rrit ndërgjegjësimin për veprimet e mundshme për të siguruar që viktimat e dhunës në familje të kenë qasje në shërbimet e nevojshme shëndetësore dhe sociale.

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim:

- Ndjek trendet dhe mbledh informacione për rastet e dhunës në familje në komunitetet joshumicë;
- Mbështet anëtarët e tjerë të MKKDHF-së në hartimin e hapave konkretë për të kontaktuar dhe rritur vetëdijësimin për dhunën në familje në mesin e komuniteteve joshumicë;
- Rrit vetëdijësimin në mesin e anëtarëve të MKKDHF-së se si të trajtohet çështja e dhunës në familje në komunitetet joshumicë dhe ofron të dhëna të nevojshme për MKKDHF-në duke siguruar gjithashtu konfidencialitetin e të dhënave të ofruara.

Policia e Kosovës/ Seksioni kundër Dhunës në Familje:

- Vepron si pika e parë e kontaktit për viktimat e dhunës në familje, ofron informacionin e nevojshëm për viktimat, udhëzon viktimat në procesin e reagimit dhe në mënyrë konfidenciale i referon viktimat tek aktorë e tjerë në përputhje me PSV-në;
- Heton rastet; ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për t'i mbrojtur viktimat e dhunës në familje duke përdorur masa proporcionale sipas ligjit në fuqi; ekzekuton urdhrat për mbrojtje dhe urdhrat për mbrojtje emergjente; lëshon urdhra të përkohshëm për mbrojtje emergjente; dhe ndalon kryerësit e dyshuar të dhunës në familje me qëllim të parandalimit të dhunës së mëtejshme;

- Mbledh të dhënat e raportuara nga viktimat për rastet e dhunës në familje dhe ofron të dhëna përkatëse statistikore dhe analitike për anëtarët e MKKDHF-së, duke rritur ndërgjegjësimin për rastet e dhunës në familje.

Inspektorati Policor/Departamenti i Hetimeve:

- Mbështet dhe mbron viktimat e dhunës në familje nga kryerësit;
- Bashkëpunon me MKKDHF-të duke ofruar të dhëna përkatëse statistikore dhe analitike.

Prokurori:

- Heton rastet e pretenduara të dhunës në familje dhe përcakton nëse ka prova të mjaftueshme për t'i ndjekur penalisht kryerësit e dhunës në familje; Duhet ta informojë viktimën për statusin e rastit;
- Mbështet punën e MKKDHF-së përmes trajtimit me prioritet të rasteve të dhunës në familje, duke raportuar në MKKDHF për rezultatet (duke ruajtur konfidencialitetin e çdo informacioni jopublik ose konfidencial).

Gjyqtarët:

- Gjykojnë rastet e dhunës në familje brenda një kohe të arsyeshme; garantojnë respektimin e standardeve të gjykimit të drejtë; garantojnë barazinë e armëve; dhe sigurojë që të drejtat e të pandehurit dhe viktimës mbrohen;
- Lëshojnë urdhra mbrojtës kur kërkohet ose kur është e këshillueshme sipas ligjit në fuqi;
- Ndajnë informacione publike dhe trendet e rasteve që kanë të bëjnë me dhunën në familje; vënë në dukje çfarëdo problemi me ligjin.

Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave/Mbrojtësit e Viktimave:

- Vendos kontaktet fillestare, këshillon dhe përfaqëson viktimat e dhunës në familje; merr pjesë në seancat gjyqësore dhe mbështet viktimat gjatë gjithë procesit gjyqësor;
- Ofron informacion për viktimat e dhunës në familje për të drejtat e tyre dhe shërbimet në dispozicion;
- Këshillon dhe inicon procedura për caktimin e masave mbrojtëse dhe lëshimin e urdhrave mbrojtës;
- Mbështet punën e MKKDHF duke ofruar informacione përkatëse në mënyrë që anëtarët të jenë të vetëdijshëm për shërbimet në dispozicion të viktimave.

Agjencia për Ndhmë Juridike Falas:

- Ofron ndihmë juridike falas sipas ligjit të Kosovës; mundëson qasje në drejtësi për viktimat e dhunës në familje duke i këshilluar për të drejtat e tyre ligjore;
- Përfaqëson viktimat para gjykatave ose organeve administrative; ofron mbështetje në hartimin e dokumenteve ligjore;
- Ndan informacion publik për rastet e dhunës në familje me anëtarët e tjerë të MKKDHF-së ku janë ofruar shërbime të ndihmës juridike falas; përgjithësisht përshkruan shërbimet e ofruara duke ruajtur ndërkohë konfidencialitetin;
- Organizon fushata ndërgjegjësimi ligjor duke u fokusuar në grupe specifike më të prekura nga dhuna në familje në bashkëpunim me MKKDHF.

Qendra për Punë Sociale:

- Ndhmon viktimat e dhunës në familje gjatë gjithë procesit të identifikimit, referimit, mbrojtjes, koordinimit, rehabilitimit dhe riintegrit në shoqëri;
- Ndhmon viktimat e dhunës në familje me shërbime sociale;
- Ofron lloje të tjera mbështetjeje për viktimat e dhunës në familje përmes këshillimit dhe koordinimit me institucionet e tjera përkatëse;
- Referon viktimat e dhunës në familje në shërbime të tjera nëse është e nevojshme;
- Siguron mbrojtje për grupe të veçanta të viktimave të dhunës në familje, si fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit;
- Mbështet fushatat për ndërgjegjësimin e viktimave të dhunës në familje për shërbimet sociale në dispozicion për mbrojtje dhe riintegrim;
- Ndërlidhet me anëtarët e tjerë të MKKDHF për të vendosur në strehimore viktimat e dhunës në familje për t'i mbrojtur ato nga dhuna shtesë;

Strehimore për viktimat e DHF:

- Ofron hapësirë të sigurt dhe të mbrojtur për viktimat e dhunës në familje;
- Kryen kërkime dhe ofron të dhëna të kategorizuara sipas gjinisë për viktimat e vendosura në strehimore;
- Ndërlidhet me anëtarët e tjerë të MKKDHF-së për të lehtësuar qasjen në shërbime për viktimat e dhunës në familje, dhe avokon për mbështetje të qëndrueshme pas largimit të viktimave nga strehimorja.

Zyra Rajonale e Punësimit:

- Regjistron viktimat e dhunës në familje në evidencën e punëkërkesve dhe personave të papunë;
- Ofron mbështetje për viktimat me punësim (një nevojë kryesore e identifikuar e viktimave të DHF); ofron trajnime profesionale dhe asistencë për t'u përgatitur për aplikimin për punë dhe hyrje në treg të punës;
- Rrit ndërgjegjësimin e anëtarëve të MKKDHF për lidhjen ndërmjet dhunës në familje dhe papunësisë dhe vështirësive ekonomike me të cilat përballen viktimat dhe familjet e tyre.

Qendra e Shëndetit Familjar dhe institucionet shëndetësore:

- Identifikon shenjat e para të abuzimit të viktimave potenciale të dhunës në familje, u ofron viktimave trajtimin e nevojshëm mjekësor dhe psikologjik.
- Ofron informacion për viktimat dhe i referon ato te ofruesit përkatës të shërbimeve në përputhje me PSV-të;
- Regjistron lëndimet dhe përgatit raporte me shkrim të rasteve kur kërkohet nga autoritetet e zbatimit të ligjit;
- Zbaton protokollet e kujdesit mjekësor;
- Ruan dosjet e lëndëve konfidenciale në bazë të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Ofron trajtim mjekësor për personat e varur nga droga dhe alkooli dhe ofron trajtim psikosocial për kryerësit e dhunës në familje nëse kërkohet nga gjykata;
- Ofron trajnime të specializuara për personelin mjekësor për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, duke përfshirë përgjegjësitë dhe detyrimet ligjore;
- Kontribuon në takimet e MKKDHF duke ofruar informacion për të ndihmuar në zhvillimin e një plani gjithëpërfshirës për nevojat e trajtimit mjekësor të viktimave të DHF.

OSHC-të lokale që fokusohen në dhunën në familje, barazinë gjinore dhe mbrojtjen e të drejtave të grupeve të cenueshme (gratë, fëmijët, komunitetet joshumicë dhe personat me aftësi të kufizuara):

- Mbledhin informacione të raportuar nga viktimat e dhunës në familje; ofrojnë kërkime dhe zhvillim të fushatave apo programeve ndërgjegjësuese për trajtimet e mundshme të viktimave të dhunës në familje;
- Ndajnë informacion mbi tendencat e dhunës në familje;

- Mbështesin anëtarët e MKKDHF-së për të hartuar dhe zbatuar fushata për ngritjen e vetëdijes në komunë;
- Kontribuojnë në takimet e MKKDHF duke ofruar informacion të përgjithshëm për rastet e dhunës në familje, duke siguruar gjithashtu konfidencialitet në raste të veçanta.

Institucioni i Avokatit të Popullit:

- Heton dhe trajton shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut të shkaktuara nga autoritetet, duke përfshirë keqtrajtimin e viktimave të dhunës në familje nga institucionet;
- Ofron rekomandime për institucionet përkatëse për të adresuar shqetësimet rreth të drejtave të njeriut;
- Ndjek punën e MKKDHF dhe identifikon fushat e mundshme ku mund të shkelen të drejtat e viktimave të DHF.

Roli i Koordinatorit të MKKDHF

Koordinatori i MKKDHF është një nga rolet më të rëndësishme në MKKDHF. Përgjegjësitë kryesore të Koordinatorit janë përshkruar si më poshtë:

- Fton anëtarët e MKKDHF në takime, harton procesverbale nga takimi (ose e cakton/delegon këtë detyrë) dhe përcakton dhe përcjell realizimin e pikave të veprimit pas takimit;
- Inkurajon pjesëmarrjen në mbledhje nga sa më shumë anëtarë ose zëvendësues të tyre, duke i kushtuar vëmendje të veçantë përfaqësimit të të gjithë sektorëve;
- Siguron procese të rregullta të komunikimit të brendshëm – siç janë caktimi i orarit të takimeve, nxjerrja e pikave me progres, komisionimi i raporteve të progresit etj.;
- Zhvillon dhe finalizon strategjitë komunale dhe planet vjetore të veprimit/punës së MKKDHF-së për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe ia paraqet ato Kuvendit Komunal për miratim;
- Dorëzon raporte tremujore dhe vjetore mbi funksionimin e MKKDHF-ve tek menaxhmenti komunal, Agjencia për Barazi Gjinore dhe Koordinatorin të Kosovës kundër Dhunës në Familje.

Lista kontrolluese për Koordinatorin e MKKDHF

- Të sigurojë dhe avokojë për përbërje të barabartë gjinore dhe përfaqësim të barabartë të komuniteteve joshumicë në strukturën e MKKDHF-së
- Të organizojë dhe koordinojë takimeve të rregullta të MKKDHF-së
- Të organizojë dhe koordinojë takimet ad-hoc të MKKDHF
- Të propozojë dhe shpërndajë agjendën e takimeve të MKKDHF
- Të sigurojë që lista e pjesëmarrësve të jetë e disponueshme dhe e përditësuar
- Të sigurojë që shërbimet e përkthimit të jenë të disponueshme
- Të sigurojë që procesverbalit i mbledhjeve të mbahet dhe të ndahet me anëtarët e MKKDHF për komentet e tyre
- Të sigurojë që dokumentet e tjera relevante të ndahen në kohën e duhur me anëtarët e MKKDHF
- Të sigurojë që të mblidhen dhe të përpilohen raporte tremujore për viktimat e asistuar të dhunës në familje (duke siguruar respektimin e të drejtave të privatësisë)
- Të mbledhë raporte narrative tremujore nga secili anëtar i MKKDHF
- Të prezantojë punën e MKKDHF menaxhmentit të lartë të komunës dhe Kuvendit të Komunës
- Të përgatisë raporte tremujore dhe vjetore dhe dorëzoni në institucionet përkatëse
- Të koordinojë vlerësimet e nevojave të MKKDHF
- Të sigurojë integrimin e vlerësimeve të nevojave në planin e punës dhe objektivat e MKKDHF
- Të koordinojë iniciativat e avokimit dhe zbatimin e aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit të MKKDHF
- Të avokojë për të siguruar buxhet komunal për funksionimin e MKKDHF-së
- Të avokojë për të siguruar zbatim të rekomandimeve të MKKDHF

VI TAKIMET E MKKDHF-SË

Për të funksionuar siç duhet, anëtarët e MKKDHF-së duhet të mbajnë takime të rregullta, të cilat planifikohen paraprakisht me pika përkatëse të rendit të ditës. Informacioni i mëposhtëm ofron udhëzime për këto takime. Lista nuk është shteruese dhe nevojat e MKKDHF-ve individuale mund të ndryshojnë. Lista ofron udhëzime për takimet, duke përfshirë hapat që duhen ndjekur para, gjatë dhe pas takimit për të siguruar dokumentimin dhe vazhdimësinë e duhur.

Shpeshësia e takimeve dhe pjesëmarrja në MKKDHF

- Takimet e MKKDHF me të gjithë anëtarët duhet të mbahen së paku çdo tre muaj;
- Anëtarët e MKKDHF-ve mund të takohen edhe sipas rastit kur nevojitet për të diskutuar tema specifike. Takimet ad-hoc mund të thirren nga secili anëtar, me njoftimin e duhur për to;
- Takimet mund të mbahen në objektet e komunës ose në ndonjë hapësirë tjetër të përshtatshme për anëtarët e MKKDHF-ve;
- Përkthyesit e komunës apo vullnetarët ofrojnë shërbime përkthimi dhe interpretimi gjatë takimeve, si dhe shërbime logjistike (mbajtja e procesverbalit, përpilimi i raporteve, etj.).

Shënim: *Meqenëse MKKDHF-të nuk fokusohen në rastet individuale, reaguesit e vijës së parë (mbrojtësit e viktimave, policia, stafi i strehimoreve, QPS-së) mund të duan të takohen veçmas për të diskutuar rastet individuale, por vetëm kur sigurohen që të drejtat e privatësisë dhe konfidencialiteti i viktimave janë të mbrojtura dhe në përputhje me ligjin.*

Përgatitjet për mbledhjet e MKKDHF-ve

Koordinatori i MKKDHF-së ose zëvendësi i tij/saj udhëheq procesin përpara mbledhjes, duke ndjekur këta hapa:

- Konsultimi me anëtarët tjerë të MKKDHF-së dhe vendimi për qëllimin dhe temat e takimit;
- Caktimi i datës, kohës dhe vendit të mbledhjes së ardhshme të MKKDHF-së;

- Përgatitja e draftit të rendit të ditës dhe dërgimi tek anëtarët tjerë të MKKDHF-së me email për kontributin e tyre; plotësimi i rendit të ditës, si dhe dërgimi i versionit përfundimtar të rendit të ditës tek të gjithë anëtarët e MKKDHF-së së paku një javë para mbledhjes vijuese, duke i ftuar anëtarët të shtojnë pika të mundshme të e rendit të ditës;
- Përgatitja dhe shpërndarja e dokumenteve përkatëse, kontributeve dhe rezultateve së paku një javë para mbledhjes;
- Caktimi i personit që mban dhe harton procesverbalin e mbledhjes;
- Sigurimi i shërbimeve të përkthimit/interpretimit.

Mbajtja e mbledhjes së MKKDHF-së

Gjatë mbledhjes, Koordinator i MKKDHF-së (ose zëvendësuesi i tij) ndjek hapat vijues:

- Fillon mbledhjen me kohë;
- Shpërndan listën e pjesëmarrësve;
- Siguron që shërbimet e përkthimit të jenë në dispozicion kur nevojiten;
- Nxit diskutimin interaktiv;
- I jep kohë të mjaftueshme secilit pjesëmarrës;
- Siguron që mbledhja të ketë diskutim të baraspeshuar mbi statistikat, prirjet, avokimin dhe aktivitetet;
- Thekson se qëllimi i MKKDHF-së nuk është të diskutojë rastet individuale në nivelin e politikave lokale, por t'i referojë rastet për menaxhim tek institucionet përkatëse (me udhëzime për mbrojtjen e të drejtave të privatësisë së viktimave).

Mbyllja e mbledhjes së MKKDHF-së

Përpara përfundimit të mbledhjes së MKKDHF-së, Koordinator i MKKDHF-së ose zëvendësuesi i tij vepron si vijon:

- Përmbledh pikat e mbledhjes;
- Vlerëson mbledhjen;
- Harton pikat e veprimt;
- Cakton datën, orën tentative, si dhe gjen vendin e mbledhjes së ardhshëm;
- Kontakton me anëtarët e tjerë për të konfirmuar datën e mbledhjes së ardhshme.

Pas mbledhjes të MKKDHF-së

- Brenda një jave pas takimit, Koordinator shpërndan Procesverbalin e takimit në shqip dhe serbisht ose në gjuhët tjera zyrtare lokale;
- Komentet dhe kontributet në mbledhje të përfshihen në draft-procesverbalin e mbledhjes brenda një jave;
- Përkthyesi i komunës ose një vullnetar që flet rrjedhshëm gjuhën shqipe dhe serbe ose ndonjë gjuhë tjetër zyrtare lokale përkthen procesverbalin e mbledhjes.

Puna e MKKDHF-së duhet të dokumentohet mirëfilli, duke përdorur forma standarde për procesverbalet e mbledhjeve, lista kontrolluese dhe çfarëdo lloj dokumenti tjetër që ndihmon në strukturimin e punës së tij.

VII MBLEDHJA, ANALIZIMI DHE RAPORTIMI I TË DHËNAVE

MKKDHF-të duhet të mbledhin të dhëna dhe të raportojnë me qëllim të:

- Hartimit të politikave lokale dhe parandaluese të bazuara në prova për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje; Raportimit të bëhet te administrata komunale dhe organi qendror koordinues ndërinstitucional për rezultatet e tij;
- Ofrimit të rekomandimeve për institucionet lokale kur hartojnë programe e politika të ndryshme (p.sh. për banimin social, programet e trajnimit profesional) për viktimat/të mbijetuarat e dhunës në familje bazuar në të dhënat e mbledhura;
- Monitorimit të prirjeve në komunën përkatëse për të rekomanduar ndërhyrje dhe për të hartuar politika të reja;
- Ofrimit të përkrahjes për riintegrim dhe fuqizim të viktimave/të mbijetuarve të dhunës në familje;
- Monitorimit dhe vlerësimit të punës së organit koordinues ndërinstitucional në nivel lokal.¹⁴

Monitorimi i rregullt, mbledhja e të dhënave dhe analizimi i rasteve, zhvillimeve dhe tendencave që kanë të bëjnë me dhunën në familje sigurojnë llogaridhënie dhe besueshmëri të punës së MKKDHF-së kundrejt autoriteteve qeveritare dhe donatorëve.

MKKDHF-ja duhet t'i përdorë këto informata për të raportuar mbi progresin, për t'i identifikuar sfidat dhe rreziqet dhe për të siguruar kujtesë institucionale. Për më tepër, raportimi i rregullt rrit edhe viziibilitetin e punës së MKKDHF-së dhe siguron llogaridhënie.

Mbledhja dhe analizimi i të dhënave

Mbledhja e të dhënave është qenësore në luftën e MKKDHF-ve kundër dhunës në familje, për tri arsye kryesore. Së pari, për të ngritur vetëdijen për këtë çështje tek politikëbërësit dhe publiku, MKKDHF-të duhet të kenë të dhëna të sakta për problemin. Së dyti, prioritizimi i mbledhjes së të dhënave mund të nxisë raportim nga viktimat ose dëshmitarët. Së fundmi, mbledhja e të dhënave ndihmon MKKDHF-në të vlerësojë

14 Reagimi shumë-sektorial ndaj DHBGJ-së: Mënyrë efektive dhe e koordinuar për të mbrojtur dhe fuqizuar viktimat/të mbijetuarit e DHBGJ-së, UNFPA, 2015, https://eeca.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/Përgjigje_multisektorale_ndaj_GBV.pdf

efektshmërinë e politikave ekzistuese dhe të ndryshojë orientimin kur është e nevojshme.

Në këtë drejtim, mbledhja e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe komuniteteve është thelbësore për të siguruar reagim me ndjeshmëri gjinore për të mbijetuarit e dhunës në familje. Mbledhja, analizimi dhe shpërndarja e rregullt e të dhënave, të zbërthyera sipas gjinisë jo vetëm që hedh dritë mbi situatën komplekse, por edhe ofron informata me rëndësi jetike e qenësore për zhvillimin e një reagimi të duhur dhe vendime të mira politike.

Raportimi

Ekzistojnë dy nivele të rëndësishme të raportimit. Në nivelin e parë, anëtarët e MKKDHF-ve duhet të ndajnë informata e statistika institucionale për dhunën në familje, të cilat pastaj ndihmojnë MKKDHF-në në punën e tij. Në nivelin e dytë, MKKDHF-ja duhet të raportojë për takimet dhe punët e tjera që pastaj i mundësojnë politikëbërësve të miratojnë rregullore, akte ligjore e politika të reja për të trajtuar më mirë problemin e dhunës në familje. Vini re që periudhat e sugjeruara të raportimit në vijim janë vetëm për ilustrim, dhe mund t'u përshtaten nevojave specifike të MKKDHF-ve, komunave dhe politikëbërësve përkatës (si p.sh. kryetari i komunës):

- Secili anëtar i MKKDHF-së duhet të përgatisë raporte të shkruara tremujore (ose më të shpeshta) që t'i dorëzohen Koordinatorit të MKKDHF-së për punën e tyre institucionale në lidhje me dhunën në familje e që fokusohet në zhvillimet kryesore, sfidat, sukseset, aktivitetet (siç është vetëdijesimi), si dhe statistika që do të ishin të dobishme për MKKDHF-në ose zyrtarët e komunës (Shih Shtojcën 5 për një shembull Raporti tremujor).
- Anëtarët e MKKDHF-së që janë ofrues të drejtpërdrejtë të shërbimeve duhet të mbledhin të dhëna të ndara sipas gjinisë për viktimat e dhunës në familje dhe të dorëzojnë raporte mujore te Koordinatori i MKKDHF-së.
- Anëtarët e tjerë të MKKDHF-së duhet të ofrojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë për shërbimet e tjera të ofruara për viktimat e dhunës në familje në baza tremujore (Shih Shtojcën 5).
- Koordinatori duhet t'i dorëzojë raportet tremujore dhe vjetore kryetarit dhe nënkryetarëve përkatës të komunës që fokusohen në punën e MKKDHF-së dhe situatën e dhunës në familje në komunë. Një kopje e raportit duhet të ndahet me anëtarët e tjerë të MKKDHF-së.

- Koordinator i duhet të dorëzojë raporte të shkruara tremujore dhe vjetore për situatën e dhunës në familje në komunë tek Koordinator i Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Agjencia për Barazi Gjinore.
- Koordinator i duhet t'u ofrojë anëtarëve të Kuvendit Komunal raporte vjetore të punës së MKKDHF-së që fokusohen në punën e MKKDHF-së dhe situatën e dhunës në familje në komunë.
- Koordinator i gjithashtu mund të ndajë raportet e MKKDHF-së me MKKDHF të tjera në komunat e tjera, për të zbuluar praktikën më të mira dhe problemet e përbashkëta që kërkojnë vëmendje nga niveli qendror.
- Raportimi gjatë mbledhjeve mund të jetë me gojë ose me shkrim.
- Asnjë informacion personal ose privat (sidomos për rastet individuale) nuk duhet të shpaloset në raportet e MKKDHF-ve.

VIII TRAJNIMI DHE ZHVILLIMI I KAPACITETEVE PËR ANËTARËT E MKKDHF-VE

Trajnimi bazë dhe i avancuar për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje kontribuon në përcaktimin e prioriteteve, ngritjen e vetëdijes dhe zhvillimin e reagimit adekuat lokal.

Të gjitha trajnimet duhet t'i diskutojnë standardet më të mira ndërkombëtare, krahas ligjeve dhe udhëzimeve të politikave përkatëse. Projektligji i pritur për dhunën në familje duhet të përforcojë e qartësojë më tej bazën ligjore për mekanizmat koordinues ndërinstitucionalë, siç janë MKKDHF-të. Më praktikisht, ligji i ri duhet të përmbajë detyrim më të qartë ligjor për anëtarët e institucioneve përkatëse që të marrin pjesë në MKKDHF dhe të përcaktojë që MKKDHF-të të kenë buxhetin adekuat për punën e tyre. Pasi të miratohet ligji dhe të finalizohen protokollet përkatëse, ato duhet të përfshihen në trajnimin e detyrueshëm të anëtarëve të MKKDHF-së.

Programi i trajnimit për anëtarët e MKKDHF-ve duhet të mbështetet me doracakë përkatës të trajnimit për dhunën ndaj grave. Doracakët e trajnimit mund të shërbejnë si vegël që trajton një sërë temash dhe mësim interaktiv. OSHC-të e specializuara të grave mund të japin kontribut të thuktë në hartimin e programit të trajnimit, hartimin e doracakut për dhunën ndaj grave dhe ofrimin e trajnimeve. Programi i trajnimit duhet t'u ofrojë profesionistëve pasqyrë të qartë të fenomenit të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe dinamikën e marrëdhënies ndërmjet viktimës/të mbijetuarit dhe dhunuesit. Siç përmendet në Raportin Shpjegues të Konventës së Stambollit, trajnimi për dhunën ndaj grave duhet të mbështetet dhe përforcohet me udhëzime të qarta që vënë standardet e punës së secilit anëtar të MKKDHF-së.

Anëtarët e MKKDHF-së duhet të identifikojnë nevojat për trajnim të anëtarëve të tyre individualë dhe të avokojnë për përfshirjen e tyre në planet e tyre të punës. Trajnimet që fokusohen në fusha specifike mund të ofrohen nga qeveria dhe institucionet lokale, organizatat ndërkombëtare dhe OSHC-të. Anëtarët e MKKDHF-së duhet të shfaqin përkushtimin e tyre dhe të ndjekin trajnime për të siguruar ofrim të shërbimeve efikase dhe me ndjeshmëri gjinore për viktimat/të mbijetuarit bazuar në nevojat e tyre, duke shmangur riviktimizimin e mëtejshëm.

Trajnimi për MKKDHF-të duhet të ndahet në fushat e mëposhtme:

1. **Trajnimi bazë** për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, që fokusohet në tema si barazia gjinore; format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje; pasojat mbi viktimat dhe komunitetet; shërbimet lokale në dispozicion për gratë dhe fëmijët viktimat të DHBGJ-së; mbrojtja e konfidencialitetit të viktimave dhe të drejtave të privatësisë në pajtim me ligjin vendor dhe standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira.
2. **Trajnimi tematik për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje** mund të fokusohet në dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje ndaj personave me aftësi të kufizuara, fuqizimin ekonomik të grave në kontekstin lokal dhe ofrimin e shërbimeve.
3. **Trajnimi ndërsektorial** mbi dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje duhet të trajtojë koordinimin ndërsektorial të MKKDHF-ve (si p.sh. koordinimi polici/prokurori); rolet e anëtarëve të MKKDHF; hartimi i politikave me ndjeshmëri gjinore; përfshirja e palëve të interesit në nivel lokal; bashkëpunimi rajonal; si dhe standardet e raportimit.

SHTOJCAT

Shtojca 1: Korniza ligjore dhe e politikave që rregullojnë

MKKDHF-të

Kosova ka miratuar disa ligje dhe politika për të adresuar e përforcuar reagimin institucional ndaj dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Parimi i barazisë gjinore është i garantuar me Kushtetutë në Kosovë.

Neni 22 i Kushtetutës së Kosovës parasheh zbatim të drejtpërdrejtë të disa instrumenteve ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave dhe Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).

Dhuna në familje, përdhunimi, sulmi seksual, cenimi i integritetit seksual, martesë e detyruar dhe gjymtimi gjeneral femëror janë vepra penale sipas **Kodit Penal të Kosovës**.

Ligji nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (LMDHF) synon parandalimin e dhunës në familje, në të gjitha format e saj, përmes masave të duhura ligjore. Megjithatë, për shkak të nevojës për mbrojtje më të mirë nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, Kosova është në proces të miratimit të ligjit të ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore. Ligji i ri është paraparë të harmonizohet me standardet e Konventës së Stambollit, të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë. Projektligji synon gjithashtu të përmbajë dispozita të veçanta ligjore që do të sigurojnë funksionimin e mirëfilltë të MKKDHF-ve.

Më 2013, janë miratuar **Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë** (PSV). Këto PSV parashohin role dhe përgjegjësi të hollësishme ligjore dhe institucionale për institucionet kryesore dhe OSHC-të përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Ministritë e qeverisë kanë përgatitur PSV-të sektoriale për mbrojtje nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje për viktimat dhe të mbijetuarit.

Strategjia e Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2022-2026 (SKMDHF) përcakton veprimet dhe masat për luftimin e të gjitha formave të dhunës dhe dhunës në familje, si dhe shërben si udhërrëfyes për përfshirjen e një dispozite të veçantë për koordinimin ndërsektorial në Ligjin e ri për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore. Së fundmi, Kosova ka miratuar Programin për Barazi Gjinore 2020–2024 që përmban një kapitull të veçantë për rëndësinë e luftimit dhe trajtimit të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje nga institucionet e Kosovës, duke përfshirë edhe rolin e mekanizmave lokalë të koordinimit ndërsektorial.

Shtojca 2: Neni 7 i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit)

Politikat gjithëpërfshirëse dhe të bashkërenduara

Paragrafi 1 i nenit 7 i Konventës së Stambollit kërkon që palët të hartojnë dhe zbatojnë politika, të cilat duhet të përfshijnë një sërë masash që duhen marrë nga aktorë dhe agjenci të ndryshme, e që, në tërësi, ofrojnë një përgjigje tërësore për dhunën ndaj grave.

Paragrafi 2 kërkon që palët të sigurojnë që politikat e miratuara të zbatohen nëpërmjet bashkëpunimit ndërinstitucional. Shembujt e praktikave të mira në disa shtete anëtare tregojnë se rezultatet janë më të mira kur agjencitë e ligjzbatuese, gjyqësori, organizatat joqeveritare të grave, agjencitë për mbrojtjen e fëmijëve dhe partnerë të tjerë relevantë i bashkojnë forcat për një rast të caktuar, për shembull për të realizuar një vlerësim të saktë të rrezikut ose hartuar një plan të sigurisë. Ky lloj bashkëpunimi nuk duhet të mbështetet tek individët veçse të bindur për përfitimet e shkëmbimit të informacionit, por duhet të kërkojë udhëzime dhe protokolle për të gjitha agjencitë, si dhe trajnime për profesionistët lidhur me përdorimin dhe përfitimet e tyre.

Për të siguruar kontributin e ekspertizës dhe perspektivës së palëve të interesuara, agjencive dhe institucioneve në politikëbërjet në këtë fushë, paragrafi 3 bën thirrje për përfshirje të *"të gjithë aktorëve përkatës, si agjencitë qeveritare, parlamentet dhe autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organizatat e shoqërisë civile"*. Kjo është një listë jopërfundimtare e aktorëve. Varësisht nga nevojat kontekstuale, këtij forumi mund t'i bashkohen edhe pjesëmarrës të tjerë, si për shembull organizatat joqeveritare të grave, organizatat e migrantëve, institucionet fetare, etj. Institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut u referohen atyre që janë themeluar sipas parimeve të OKB-së për institucionet kombëtare për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, miratuar me Rezolutën 48/134 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara më 1993. Duke qenë se institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut ekzistojnë në shumë shtete anëtare të Këshillit të Evropës, hartuesit konsideruan se është me rëndësi që ato të përfshihen në listën e aktorëve përkatës, aty ku ekzistojnë.

Kjo dispozitë nuk përmban detyrimin për të themeluar institucione të tilla, aty ku ato nuk ekzistojnë. Duke përfshirë parlamentet kombëtare, rajonale dhe vendore në këtë dispozitë, qëllimi i hartuesve ishte që t'i pasqyrojnë nivelet e ndryshme të pushtetit ligjvënës të Shteteve Palë me sistem federal. Një mënyrë për t'i siguruar elementet e politikave gjithëpërfshirëse dhe të koordinuara nga njëra anë dhe përfshirjen e të gjitha institucioneve dhe agjencive përkatëse nga ana tjetër, është hartimi i planeve kombëtare të veprimit.¹⁵

15 Raport shpjegues për Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (CETS nr. 210) <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treaty-num=210>

Shtojca 3: Termat e Referencës së Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (shabllon)

Informata të përgjithshme

Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (MKKDHF) janë organe komunale në përbërje të institucioneve të Kosovës në nivel komunal, që kanë për qëllim mbështetjen e bashkëpunimit dhe reagimit më të mirë ndërkomunal dhe institucional për t'i ndihmuar viktimat e dhunës. Gjithashtu, ato mëtojnë aplikimin e një qasjeje tërësore dhe të qëndrueshme për t'i mbrojtur të drejtat e viktimave, si dhe për të rritur dhe bashkërenduar përpjekjet për çrënjosje të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Për më tepër, puna e MKKDHF-ve lehtëson zbatimin e kuadrit ligjor dhe të politikave dhe kontribuon në sigurinë dhe mirëqenien e grave, vajzave dhe burrave dhe djemve, si dhe në riintegrimin dhe fuqizimin e të mbijetuarve të dhunës në familje.

Objektivat dhe funksionet e MKKDHF janë:

- a) Të rrisë bashkërendimin dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve komunale, ofruesve të shërbimeve, shoqërisë civile dhe organizatave joqeveritare për të drejtat e grave që angazhohen në punë, programe dhe aktivitete në lidhje me dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave;
- b) Të jetë forum për shkëmbimin e thelluar dhe tematik të informacionit ndërmjet institucioneve dhe aktiviteteve të tyre që kanë të bëjnë me dhunën në familje, me qëllim të shkëmbimit profesional të përvojave, identifikimit të mundësive të bashkëpunimit dhe shmangies së duplikimit të aktiviteteve;
- c) T'i identifikojë dhe analizojë trendet e gjendjes së dhunës në familje në komuna për sa i përket rreziqeve të dhunës në familje, dobësive specifike dhe llojeve të incidenteve të dhunës në familje që mund të ndodhin rregullisht;
- d) T'i identifikojë në dokumentet ekzistuese ligjore dhe të politikave, siç janë manualët, udhëzimet, rregulloret dhe ligjet, fushat që kanë të bëjnë me shtrirjen e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, të kontribuojë në diskutim dhe të rekomandojë ndryshime bazuar në përvojën me trajtimin e kësaj fushe;
- e) T'i përcjell iniciativat, hulumtimet dhe dokumentet e zhvilluara në komunë dhe në Kosovë;
- f) Të avokojë për shërbime cilësore të qëndrueshme e të integruara për të mbijetuarat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, përpjekjet e avokimit për të siguruar programe riintegrimi dhe mbështetje financiare për ofruesit e strehimoreve;

- g) Të avokojë për një sistem efikas të monitorimit të ofrimit të shërbimeve për viktimat e dhunës në familje nga institucionet e Kosovës dhe strukturat tjera komunale dhe joqeveritare;
- h) Të hartojë raporte mujore të vlerësimit dhe të mbledhë statistika për viktimat e asistuara të dhunës në familje;
- i) T'i lehtësojë dhe mbështesë iniciativat ndërgjegjësuese, duke synuar bashkëbisedues të ndryshëm dhe opinionin publik për parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave;
- j) T'i bashkërendojë aktivitetet në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në komunë;
- k) Të rrisë ndërgjegjësimin lidhur me format e ndryshme të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, si dhe të llojë dhe të mbështesë hartimin e dokumenteve përkatëse të politikave që do të lejonin krijimin e një sistemi të qartë ofruesish shërbimi në përgjigje të çdo lloji të dhunës në familje, në përputhje me kërkesat e Konventës së Stambollit.

Përbërja

MKKDHF-të përbëhen kryesisht nga aktorë të nivelit lokal, duke përfshirë ofruesit kryesorë të shërbimeve komunale të dhunës në familje, përfaqësuesit komunalë, institucionet e pavarura, organizatat për të drejtat e grave dhe strehimoret për dhunën në familje.

- MKKDHF koordinohet nga Koordinatori ose zëvendësi i tij/saj.
- Anëtarët e MKKDHF marrin pjesë në takime të rregullta.
- Takimet ad-hok mund të thirren nga çdo anëtar, me së paku tri ditë njoftim paraprak.

Plani i punës dhe raportimi

- Anëtarët e MKKDHF identifikojnë dhe vlerësojnë nevojat dhe shqetësimet në lidhje me funksionalitetin e MKKDHF;
- Anëtarët e MKKDHF-së hartojnë planin vjetor të punës në fund të çdo viti/në fillim të vitit të ardhshëm. Plani i punës përditësohet dhe rishikohet duke pasur parasysh nevojat e anëtarëve, ndryshimet në përbërjen e grupit dhe faktorët e jashtëm që ndikojnë në MKKDHF;
- Në fund të çdo tremujori anëtarët e MKKDHF-së janë të obliguar t'i dorëzojnë raportet përkatëse tremujore te Koordinatori;

- Në fund të çdo muaji, anëtarët përkatës të MKKDHF-së janë të detyruar t'i dorëzojnë Koordinatorit statistikat mujore për viktimat e asistuar të dhunës në familje;
- Anëtarët e MKKDHF organizojnë dhe zbatojnë aktivitete për ngritjen e vetëdijes dhe ngritjen e kapaciteteve për përfaqësuesit e tjerë komunalë ose anëtarët e komunitetit;
- Anëtarët e MKKDHF-së, në bashkëpunim të ngushtë me Koordinatorin, avokojnë për mbrojtje të siguruar, fuqizim dhe riintegrim të të mbijetuarve të dhunës në familje.

Dokumentet referuese

Standardet më të mira ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe kuadri ligjor dhe i politikave në Kosovës udhëzojnë punën e MKKDHF-së në parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Dispozitat përfundimtare

MKKDHF-të mund të vendosin t'i ndryshojë këto Terma të Referencës, sipas nevojës.

Komuna, xx.xx.2023

Shtojca 4: Procesverbalet e takimeve të MKKDHF-së për të mbështetur koordinatorin e MKKDHF - model

Sipas Udhëzimit, kur të raportohet për rastet, raportimi nga takimet e MKKDHF duhet të jetë në përputhje me nëntë parimet, në veçanti konfidencialitetin. Për të formësuar modelin e raportimit për takimet e MKKDHF, sugjerohen pikat në vijim:

- i. Data dhe vendi i takimit
- ii. Lista e të gjithë pjesëmarrësve në takim, Emri, Mbiemri, Titulli
- iii. Përmbledhja ekzekutive e takimit dhe pasqyra e pikave të veprimit nga takimi i mëparshëm
- iv. Pika të shkurtra të të gjitha prezantimeve – me theks në çështjet kryesore të paraqitura nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme
- v. Aktivitetet përcjellëse
- vi. Data e takimit të radhës të MKKDHF
- vii. Shtojcat (*sipas nevojës. Ato mund të përfshijnë raporte mujore ose periodike të anëtarëve të ndryshëm të MKKDHF-ve*)

Shtojca 5: Modeli për raportet tremujore të anëtarëve të MKKDHF dhe raportet tremujore/vjetore të hartuara nga Koordinatorin e MKKDHF

Konceptet e përgjithshme që duhen marrë parasysh gjatë përgatitjes së raporteve tremujore:

- Raportet duhet të përmbajnë mesazhe kyçe të kuptueshme për audiencën e synuar;
- Raportet duhet të bazohen në informacione të sakta, duke përfshirë faktet dhe analizat e aktivitetit të monitorimit/ofrimit të shërbimeve të institucioneve përkatëse;
- Ata duhet të respektojnë konfidencialitetin e informacionit të mbledhur;
- Ata duhet të integrojnë perspektivën gjinore.

Shembull i raportit tremujor të anëtarëve të MKKDHF

i. Hyrje

- Objektivi, informata të përgjithshme dhe përmbledhje e raportit – duhet të jetë specifik për institucionin e anëtarit dhe dhunën në familje.

ii. Teksti kryesor – Tema

- Për institucionin/punëdhënësin e anëtarit, përfshini një pasqyrë të zhvillimeve të rëndësishme, të dhëna statistikore, legjislacionin përkatës, politikat dhe aktivitetet në lidhje me mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje;
- Analiza e gjetjeve të paraqitura në raport, çështjet kryesore dhe zhvillimet e mundshme në fushën e luftimit të dhunës në familje;
- Identifikimi i trendeve;
- Raport për sfidat e identifikuara gjatë periudhës raportuese;
- Veprimet e ndërmarra nga institucionet përkatëse për adresimin e sfidave dhe problematikave të evidentuara.

iii. Konkluzionet, veprimet përcjellëse dhe rekomandimet

- Konkluzionet, me veprimet përcjellëse dhe rekomandimet

Model raporti tremujor/vjetor i MKKDHF i përgatitur nga Koordinatori

Përmbledhje ekzekutive

- Përmbledhje e punës/aktiviteteve të MKKDHF;
- Përmbledhje e gjendjes së dhunës në familje në komunë dhe zhvillimet kyçe/statistikat e ë përgjithshme;
- Përmbledhje e gjetjeve, përfundimeve dhe rekomandimeve kryesore.

Metodologjia

- Metodologjia e përdorur për mbledhjen dhe paraqitjen e të dhënave është analizuar në raport.

Detajet e Raportit

- Pasqyrë e zhvillimeve të rëndësishme, të dhëna statistikore, legjislacioni përkatës, politikat dhe aktivitete në lidhje me dhunën në familje;
- Analiza e gjetjeve të paraqitura në raport, çështjet kryesore dhe zhvillimet e mundshme në fushën e luftimit të dhunës në familje;
- Identifikimi i trendeve;
- Raport për sfidat e identifikuara gjatë periudhës raportuese;
- Veprimet e ndërmarra nga MKKDHF apo institucionet specifike për adresimin e sfidave dhe problematikave të evidentuara.

Konkluzione dhe rekomandime

- Pikat kryesore të raportit;
- Veprimet përcjellëse dhe veprimet
- Rekomandime për institucionet përkatëse ose anëtarë të tjerë të MKKDHF-së, nëse ka.

Shtojcat (*sipas nevojës*)



UNITED AGAINST
GENDER-BASED
VIOLENCE

osce